

Perpunimi i mostrave



Rezultatet treguan se të gjitha mostrat e mbledhura ishin të paprekura nga patogjeni.

Disa koloni të ndryshme kërpudhore, morfologjikisht të ngjashme me speciet *Phaemoniella* dhe *Phaeoacremonium* janë izoluar në terrene PDA nga mostrat simptomatike të ullinjve në Shamogjin. Identifikimi i tyre është është në vazhdim.

Një monitorim i vazhdueshëm dhe rigoroz me një plan kontrolli fitosanitar për materialin shumëzues bimor të importuar dhe atë vendas është i nevojshëm për të parandaluar futjen e *Xylella fastidiosa* në Shqipëri.

Për më tepër, nga 21.08.2014 me Urdhrin nr. 409 të Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, është ndaluar importimi i fidanëve të ullirit nga rajoni i Puglias.

Autorët falenderojnë kolegët Italianë veçanërisht; Institutin Agronomik Mesdhetar të Barit (CIHEAM), për mbështetjen dhe asistencën me protokollet teknike të analizave, si dhe Universitetin Justus-Liebig Giessen Gjermani, për blerjen e kитеve dhe reagentëve me fondet e projektit: Quality Network Biodiversity and Agriculture on the Balkan Peninsula (BioAgBal) në kuadër të Programit DAAD.



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE DEPARTAMENTI I MBROJTTJES SË BIMËVE UBT

SENSIBILIZIM PËR RREZIKUN E THARJES SË
BIMËVE TË ULLIRIT NGA
XYLELLA FASTIDIOSA NË VENDIN TONË



Kjo fletë palosje është hartuar për:
**“Sensibilizim mbi rrezikun e tharjes së
bimëve të ullirit nga
Xylella fastidiosa”**

Magdalena Cara.; Jordan Mërkuri; Edmond Koka; Mendim Baçaj

Xylella fastidiosa është raportuar si përgjegjëse për sëmundjen e bimëve të ullirit në rajonin e Puglias (Italia Jug-Lindore) e njohur si “Sindromi i tharjes së shpejtë” (CODIRO).

Raportimi i parë i *X. fastidiosa* në Bashkimin Evropian (2013) në Puglian Jugore, Itali është i lidhur me raste të rënda të tharjes.



Itali 2013

X. fastidiosa është një patogjen karantinor. Shqipëria si vend fqinj me Italinë, me shumë shkëmbime njerëzish dhe mallrash, rrezikon hyrjen dhe përhapjen e këtij bakteri.

Sinjalet e para të kësaj sëmundjeje në vendin tonë janë që nga Maji i vitit 2014.

Simptomat të ngjashme të tharjes janë vërejtur në bimët e ullinjve të rajonit të Lushnjës, dhe më vonë në rajone të tjera si Vlora, Saranda, etj..



Maj 2014, Dushk - Lushnje



Simptomat e tharjes së gjetheve të ullirit në Shamogjin, Vlorë



Maminas, Durrës 2014 Leandër, Golem Kavajë (2015).

Për të monitoruar praninë e patogjenit në Shqipëri, është kryer një studim në territorin shqiptar, duke mbuluar zonat e dyshuara të kultivimit të ullirit.

Rezultatet paraprake janë raportuar në një artikull të publikuar në: *Journal of Multidisciplinary Engineering Science and Technology* (JMEST), Berlin. ISSN: 2458-9403 Vol. 3 Issue 10, October – 2016.

Mostrat janë mbledhur gjatë tre sezoneve vegetative: pranverë dhe vjeshtë 2014, 2015 dhe pranverë 2016, në bimët simptomatike të ullirit në Shamogjin, QTTB Vlorë (varietete të importuara nga Italia si dhe nga varietete lokale), Dushk - Lushnjë, Maminas - Durrës, Sarandë, etj.. Mostrat janë transportuar me qese plastike të mbyllura në një kuti me ftohje, në Laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve në Durrës, të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës .

Për të analizuar praninë e *X. fastidiosa*, janë kryer me testet serologjike (ELISA, DTBIA) duke përdorur antitropa specifike për *X. fastidiosa*, si dhe me analiza molekulare PCR.



QTTB-Shamogjin

Vlorë

Datë 03.10.2014

Të dhënat për çdo bimë ulliri ku janë marrë kampionat për analizë.

Emërtimi	Kultivari	Moshë e bimës/vite	Vendrtdodhja
Pema nr.1	Cazznichio	14	Shamogjin
Pema nr.2	Ogliarola	14	Shamogjin
Pema nr.3	Karolea	14	Shamogjin
Pema nr.4	Nocellara Messinese	14	Shamogjin
Pema nr.5	Coratina	14	Shamogjin
Pema nr.6	Cazznichio	14	Shamogjin
Pema nr.7	Itrana	14	Shamogjin
Pema nr.8	Richolin	14	Shamogjin
Pema nr.9	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.10	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.11	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.12	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.13	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.14	Frantolo	40	Shamogjin
Pema nr.15	Fraxhivento	40	Shamogjin
Pema nr.16	Fraxhivento	40	Shamogjin
Pema nr.17	Kalimiot		Skrofotinë
Pema nr.18	Kallemon	18	Skrofotinë